

Infektimi me morra koke**Të dashur prindër,**

në institucionin tuaj është/janë sëmurë një fëmijë/fëmijë me morra koke. Për shkak se morrat e kokës transmetohen lehtësisht nga një fëmijë të tjetri, ju lutemi ta **kontrolloni fëmijën tuaj për infektim nga morrat**. Ndihmoni për të zbuluar të gjithë fëmijët e infektuar, sepse vetëm në këtë mënyrë ndalohej shpejt qarkullimi i morrave.

Sigurojeni një krehër thërijash. Këtë e merrni në parafarmaci ose farmaci. Tregoni kujdes që distanca e dhëmbit të jetë poshtë 0.3 mm. Ideal është një ngjyrë e çelët. Përveç kësaj, ju nevojitet një krehër plastik i trashë ose një furçë plastike që mund të lahet dhe kondicioner për flokët i zakonshëm për larje dhe shamie letre ose një leckë e çelët.

Kështu veprohet:

- Lani flokët e fëmijës suaj si zakonisht.
- Shpërndani në mënyrë të njëtrajtshme kondicionerin e flokëve dhe shprishni flokë me një krehër plastik të trashë. **MOS E SHPËLANI KOKËN!**
- Është veçanërisht e rëndësishme që krehja e fijeve të flokëve të fillojë me një krehër thërijash dhe të vendoset krehri mbi një leckë. Nëse ka infektim me morra, aty shikoni morrat.
- Nëse nuk jeni të sigurt nëse është morr, prisni derisa të thahet dhe mbani një qime: Nëse ai mbahet fort dhe zvarritet mbi të, është morr.
- Pastrojeni krehrin nëse nevojitet me një furçë dhëmbësh ose me një kunj dhëmbësh.
- Flokët duhet të jenë të lidhur së bashku në 2 javët e ardhshme dhe të kontrollohen dy herë në javë për infektim me morra.

**Çfarë duhet bërë nëse gjeni morra koke:**

Vëllezërit dhe motrat dhe prindërit (gjyshërit) janë veçanërisht të rrezikuara nga infektimi, pasi morri përhapet nga kontakti flok me flok. Prandaj, në fillim kontrolloni të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes me një krehje të lagësht me një kondicioner flokësh të zakonshëm. Të gjithë fëmijët që kanë pasur kontakt me fëmijën tuaj duhet të kontrollohen. Prandaj, informoni të gjithë prindërit e prekur në mjedisin privat dhe institucionin e komunitetit, në mënyrë që fëmija juaj të mos infektohet sërish dhe të ndërpritet qarkullimi. Për trajtimin ju nevojitet një solucion kundër morrave të kokës dhe një krehër thërijash (distanca e dhëmbëve poshtë 0.3 mm) të blerë në farmaci. Përveç produkteve të pesticideve në dispozicion, janë provuar të ashtuquajturat vajra silikon. Aplikoni solucionin kundër morrave të kokës me një distancë 8-10 ditë 2x në ditë. Trajtimi i 2-të shërben për ngordhjen e vezëve të nxjerra pas aplikimi të 1-rë, para se vezët të pjellin përsëri. Krehja me krehër thërijash është veçanërisht e rëndësishme dhe duhet të bëhet me kujdes për të hequr morrat që kanë rënë dhe për të kontrolluar suksesin pas trajtimit.

Pastrim i madh në shtëpi?

Ndryshe nga ç'është supozuar më parë, pastrimi nuk është parësor, pasi morrat e kokës transmetohen shumë rrallë mbi objekte dhe mund të mbijetojnë jashtë kokës për maksimumi 2 ditë. Përqëndrohuni në kontrollimin e të gjitha kokave të familjes. Përveç kësaj, mund të pastroni me fshesë korrenti, të lani rrobat (60 °C) dhe të vendosni sendet "e bërë me morra" për 2 ditë në qese plastike.

A duhet qëndrojë në shtëpi fëmija im për shkak të morrave të kokës?

Nëse zbuloni morra koke sot dhe filloni trajtimin siç është planifikuar, fëmija juaj mund të jetë pa morra nesër. Mos harroni trajtimin e përsëritur në 8-10 ditë dhe kontrollin e suksesit nëpërmjet krehjes!



© A. Hassl

SKEMA E TRAJTIMIT

Infektimi me morra koke



Kështu e trajtoni infektimin me morra koke:

Lutemi lexoni mirë udhëzimin e përdorimit të solucionit të zgjedhur të morrave para trajtimit!

Udhëzimi hap pas hapi

Dita	Data	Çfarë duhet të bëhet? (Lutemi, shënoni me kryq pohimet që zbatohen)
Dita 1		<input type="checkbox"/> Trajtimi me produkt mjekësor të përzgjedhur nga farmacia (= solucioni kundër morrave) <input type="checkbox"/> Krehje me krehër morrash (farmaci) dhe kondicioner flokësh i zakonshëm (parafarmaci)
Dita 2		
Dita 3		
Dita 4		
Dita 5		<input type="checkbox"/> Krehje me krehër morrash (farmaci) dhe kondicioner flokësh i zakonshëm (parafarmaci)
Dita 6		
Dita 7		
Dita 8		
Dita 9¹		<input type="checkbox"/> Trajtimi me produkt mjekësor të përzgjedhur nga farmacia (= solucioni kundër morrave) <input type="checkbox"/> Krehje me krehër morrash (farmaci) dhe kondicioner flokësh i zakonshëm (parafarmaci)
Dita 10		
Dita 11		
Dita 12		
Dita 13²		<input type="checkbox"/> Krehje me krehër morrash (farmaci) dhe kondicioner flokësh i zakonshëm (parafarmaci)

¹Lutemi vini re: Trajtimi i dytë mund të kryhet edhe në ditën 8 ose 10.

²Kontroll përfundimtar, për siguri shtesë edhe një krehje tjetër në ditën 17, veçanërisht nëse ka pasur shumë morra në kokë.

Udhëzim:

- ❖ Trajtoni infektimin me morrave të kokës sipas skemës në tabelën e mësipërme ose sipas udhëzimeve për përdorimin e produktit tuaj
- ❖ Fushat gri në tabelë shënojnë ditët me hapat e trajtimit
- ❖ Dita 1 korrespondon me ditën e zbulimit të infektimit me morrave e kokës në të cilën trajtimi i parë duhet të bëhet direkt. Shënoni këtu datën.
- ❖ Pas trajtimit me sukses, vini një kryq fushës përkatëse.
- ❖ Nëse janë shënuar me kryq të gjitha fushat e ngjyrosura me gri, trajtimi ka përfunduar.
- ❖ Megjithatë, kontrolloni edhe një herë mirë kokën. Nëse infektimi ka qenë shumë i madh, këshillohet të kontrollohet disa herë me një distancë prej disa ditësh, për të qenë plotësisht të sigurt.